



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 2 Prill 2021

Nr: 16

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 10, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 02.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim përfaqësuar nga z. Ivi Kaso

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 10, të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim me objekt 1. Ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021 “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



VËREN:

Ankuesi Koalicioni Partia Demoratike – Aleanca për Ndryshim “PD-An”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr, 10 regj., datë 02.04.2021.

Në mbledhjen e datës 02.04.2021, ora 11:30, pas relatimit të z. Ledio Braho dhe diskutimit të përfaqësuesit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 10 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 10, datë 02.04.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim “PD-AN”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 03.04.2021, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

